

[Printo]

[Google Translate]

LIGJ
Nr. 14/2012

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9693, DATË 19.3.2007 "PËR FONDIN KULLOSOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 10 bëhet ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Pjesë të fondit kullosor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore me kërkesën e pronarit apo organit të qeverisjes vendore i cili e ka në pronësi këtë fond. Ndryshimi i formës së përdorimit të fondit kullosor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, pavarësisht nga madhësia e sipërfaqes, bëhet vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe politikave parësore shtetërore afatgjata."

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

"2/1. Kërkesa për kalimin e pjesëve të fondit kullosor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore paraqitet në komunën dhe/ose bashkinë, në territorin e së cilës ndodhet fondi kullosor, që shqyrtohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar.

2/2. Kalimi i resursit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisjes vendore, në fond kullosor (kullotë, livadh), dhe regjistrimi në kadastrën kombëtare të fondit kullosor bëhen me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore. Kërkesa paraqitet pranë ministrisë që mbulon pyjet dhe miratohet nga ministri përkatës."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 16.2.2012

Shpallur me dekreten nr.7305, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Copyright 2012 - www.ligjet.org